



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL
NJËSIA ADMINISTRATIVE LEZHË

Nr. 13030/4 Prot

Lezhë, më 20.08.2025

**PROCESVERBAL PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR
TË VEPRIMIT TË BARAZISË GJINORE 2025-2030**

I mbajtur sot me datë 20/08/2025 konsultimi publik për Planin Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2030 pranë bibliotekës së qytetit Lezhë sipas njoftimit publikuar në faqen ëeb të bashkisë Lezhë, në linkun si vijon: <https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-ne-lidhje-me-miratimin-e-planit-vendor-te-veprimit-per-barazi-gjinore-2025-2030/>.

Pjesëmarrës në aktivitet 38 banorë të bashkisë Lezhë, institucione, grupi i punës, kryetari dhe sekretarja e këshillit bashkiak, dhe përfaqësues nga drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social . Pas prezantimit fillestar të aktivitetit nga drejtoresha e Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social nisi dhe prezantimi i këtij plani nga specialistja e Barazisë Gjinore. Fushat kryesore të ndërhyrjes së këtij plani janë promovimi i të drejtave të grave, dhe te rejave të ndarë në 5 objektiva kryesor ndërhyrjeje. U prezantua matrica me të gjitha objektivat dhe qellimet e këtij plani në vitet 2025-2030. U shpjeguan masat dhe aktivitetet ku për secilin aktivitet janë marrë masa duke përcaktuar përgjegjësit kryesor dhe mbështetësit. Ndër përgjegjësit kryesorë janë drejtori të ndryshme të bashkisë Lezhë(drejtoria e Bujqësisë, ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shërbimit Social etj). Çdo masë dhe aktivitet do të ketë një afat kohor gjithashtu tregues ku për secilin aktivitet përcaktohet sa takime do të realizohen në vit, gjithashtu do të përcaktohet sa persona do të jenë të parashikuar në takime këto të ndarë sipas gjinisë, moshës dhe vendbanimit. Pjesëmarrësit në fund të prezantimit u ftuan që të japin mendime dhe rekomandime lidhur me Planin.

Drejtori i Zyrës Rajonale të Punësimit Lezhë mori fjalën duke hasur disa pika ku në shumë raste nuk respektohet qasja gjinore. Një mesazh sensibilizues nga ana e tij lidhur me barazinë gjinore ku gratë duhet të jenë më kërkuese dhe në vendet e punës. Sipas tij pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave çon në një vendimarrje më transparente, më cilësore,sesa në rastet kur pjesëmarrja është më e ulët. Vetëm në këtë formë mund të realizohen siç duhet objektivat e strategjive të ndryshme.

Anëtarja e Këshillit zj.A.Marku u shpreh se duhet të fokusohemi secili për të marrë përgjegjësi dhe angazhime. Duhet të kishte më shumë pjesëmarrës si gra ashtu dhe burra. Përfashtimi nga detyrimet vendore të jetë për të gjithë vajzat dhe gratë në nevojë ishte dhe sugjerimi tjetër i saj. Lidhur me çerdhet publike të qytetit duke parë mbingarkesën që ka duhet që kapaciteti frekuentues ti përafrohet kërkesave. Pamundësia për të mos sistemuar fëmijët në çerdhe pengon papunësinë e nënave. Ndërtimi i tregjeve lokale do ti jepte mundësi grave të tregtojnë dhe të fuqizohen. Vlerësohet në tërësi avancimi i drejtorisë së Shërbimeve Sociale që ka pasur ndër vite



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

Drejtoresha e Shërbimit dhe Kujdesit Social zj.M.Fetaj falenderon UNËomen dhe stafin e saj për angazhimin për të përgatitur këtë plan.

Procesverbali u mbajt nga :Desara Marku
Drejtori i Shërbimit Social: Marte Fetaj
Sekretare e Këshillit Bashkiak :Florida Çunaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

